FEDERATA E GJIMNASTIKËS E KOSOVËS
KOSOVA GYMNASTICS FEDERATION

Raporti i garës Šalamunov Memorial 2025

Federata e Gjimnastikës e Kosovës, bazuar në kalendarin e garave të saj, mori pjesë në garën ndërkombëtare "56th Šalamunov Memorial 2025".
Kjo garë është garë zyrtare e FIG, me numër Event ID: 18097, dhe njihet nga Federata Ndërkombëtare e Gjimnastikës.
Federata pritëse (host federation) ishte Slovenian Gymnastics Federation, ndërsa komiteti organizativ i garës ishte Društvo za šport in rekreacijo Železničar Maribor.

Lokacioni i garës**:** Sports Hall Tabor (Dvorana Tabor), Koresova ulica 7, 2000 Maribor, Slovenia
Hoteli ku qëndroi ekipi i Kosovës: Hotel Tabor Maribor



FGJK – KGF
Shtëpia e Sporteve, Rr: "Agim Ramadani" 10000 Prishtine, tel: +38344145009, email: kosovagymnasticsfederation@gmail.com

Dhjetë gjimnaste nga Kosova:
Në kategorinë Children (fëmijë): Hira Elshani
Në kategorinë Youth (të reja): Fernaze Cakaj, Hira Haziri, Djellona Azemi
Në kategorinë Juniore: Sara Pllana, Rea Berisha, Bora Hoti
Në kategorinë Seniore: Valëza Rama, Kaltrina Thaqi, Vileza Zeqiri
Kryetari i Federatës (Head of Delegation): Shkumbin Maqastena
Trajnerë: Doruntinë Ibrahimi, Abeliana Bregu, Arlind Shaqiri, Besnik Latifi
Fizioterapiste: Qëndresa Hyseni
Nisja nga Kosova u bë nga parkingu prapa Pallatit të Rinisë dhe Sporteve, më datë 03 Qershor 2025, nga ora 23:00.

Dita 1 **04 Qershor 2025**





Sara Pllana, Hira Haziri, Fernaze Cakaj dhe Valëza Rama me trajnerët Doruntine Ibrahimi dhe Arlind Shaqiri nuk udhëtuan së bashku me pjesën tjetër të ekipit nga Prishtina, sepse ishin pjesë e një kampi stërvitor në Kroaci. Takimi u bë në hotel në Maribor rreth orës 12:00, kur arriti edhe autobusi nga Kosova.
Akomodimi u bë ne dhoma 2-she dhe 3-she si në vijim:
-Shkumbin Maqastena, Abeliana Bregu, Majeza Maqastena
-Hira Haziri, Djellona Azemi
-Doruntine Ibrahimi, Hira Haziri, Fernaze Cakaj
-Rea Berisha dhe Bora Hoti
-Qendresa Hyseni, Sara Pllana dhe Valëza Rama
-Kaltrina Thaqi dhe Vileza Zeqiri
-Besnik Latifi dhe Arlind Shaqiri

Pas një pushimi prej një ore, ekipi shkoi për drekë në sallën e garës, te kuzhina ne katin 1, që ndodhej shumë afër hotelit, siq shihet nga foto e pare, rreth 1 minut ecje.
Nga ora 16:00 deri në ora 18:30 u zhvillua stërvitja e parë në sallën e garës (free training).
Darka ishte nga ora 19:00. Nga ora 19:15 u mbajt mbledhja orientuese.

Dita 2 **05 Qershor 2025**



Pas mëngjesit dhe përgatitjes me veshje gjimnastikore, ekipi i Kosovës shkoi në sallën e garës për të filluar garën me grupmoshën e parë, Children**.**
Nga Kosova garoi Hira Elshani.
09:00 – 09:20 Nxemja gjenerale
09:20 – 10:00 Nxemja per secilen vegel (4 x 10 min)
10:00 – 11:40 Gara per femijet
Rezultatet e Hira Elshanit:
21.816 pikë në all around – vendi i 29 nga 30 garuese.

Pasdite gara vazhdoi me kategorinë Youth (të reja)**.**
Gjimnastet pjesëmarrëse nga Kosova: Fernaze Cakaj, Hira Haziri, Djellona Azemi
14:30 – 14:50 Nxemja gjenerale
14:50 – 15:30 Nxemja per secilen vegel (4 x 10 min)
15:30 – 17:00 Gara per youth

Rezultatet individuale:
Fernaze Cakaj – vendi i 3-të nga 42 garuese, 43.366 pikë – medalje e bronztë
Hira Haziri – vendi i 10-të me 39.999 pikë
Djellona Azemi – vendi i 36-të me 26.916 pikë
Rezultatet në ekipore: vendi i 6-të me 110.281 pikë

Pas përfundimit të garës, nisi menjëherë stërvitja për juniore dhe seniore (17:15 – 19:30).
Pas stërvitjes, ekipi shkoj per darke dhe pastaj shkoj ne hotel per pushim për ditën tjetër.

Dita 3 **06 Qershor 2025**





Në ditën e tretë ishte gara per seniore ne mengjes dhe per juniore pasdite. Gara e senioreve ishte e ndare ne 2 grupe, ndersa ekipi i Kosoves ishte ne grupin 1, prandaj ne ora 08:20 duhet te ishte ne salle per të filluar nxemjet.
08:20 – 08:40 Nxemja gjenerale
08:40 – 09:20 Nxemja në seclien vegël
09:20 – 11:00 Gara e senioreve

Rezultatet individuale:
Kaltrina Thaqi – vendi i 13-të me 39.750 pikë dhe me një rezultat të mire në kapërcime kualifikohet për finale. Ajo në kapërcime kishte këtë rezultat:
Tentimi 1: 12.700
Tentimi 2: 11.950
Valëza Rama – vendi i 20-të me 37.550 pikë.
Vileza Zeqiri – vendi i 27-të me 30.150 pikë. Në kategorinë senior ishin 35 garuese total.
Rezultatet në ekipore**:** vendi i 6-të me 107.450 pikë

Pasdite, kategoria junior:
13:50 – 14:10 Nxemja gjenerale
14:10 – 15:10 Nxemja në seclien vegël
15:10 – 17:30 Gara e junioreve

Rezultatet individuale:
Sara Pllana – 43.650 pikë, vendi i 5-të – kualifikohet për finale në parter dhe kapërcime
Parter: 11.700 dhe kapercime: 12.350 tentimi i parë dhe 12.450 tentimi i dytë.
Bora Hoti – 38.350 pikë, vendi i 22-të
Rea Berisha – 36.400 pikë, vendi i 26-të

Rezultatet ekipore: vendi i 5-të nga 8 ekipe me 118.400 pikë. Ne kategrinë juniore ishin 38 garuese pjesëmrrëse.

Dita 4 **07 Qershor 2025**







Në diten e 4 nuk pati garuese nga Kosova, pasi ishte dita e garës për meshkuj.
Pas ngrenjës së mëngjesit në hotel, pjesa e parë e ditës u shfrytëzua për shëtitje në Maribor.
Pas shëtitjes ekipi shkoj direkt te kuzhina ku servohet dreka.
Pas drekës, finalistët kryen stërvitje shtesë në sale nën komandat e trajnerëve të tyre. Kaltrina Thaqi ushtroj në kapërcime ndërsa Sara Pllana në parter dhe pak në kapërcime. Si cdo ditë Qendresa ishte afër ekipit me ndihmen e saj si fizioterapeute.

Organizatorët e kësaj gare cdo vit e mbajnë një festë/banket me ekipet pjesëmarrëse, e njejt vepruan edhe këtë vit.
Nga ora Ora 20:00 deri 23:00 ishte ky banket. Ekipi qëndroi rreth një orë dhe më pas u kthye në hotel, ku stafi i trajnerëve qëndoj pak në ambientet e hotelit dhe diskutuan në lidhje me ecurinë e garës dhe planeve për finalen e nesërme.

Dita 5 **08 Qershor 2025 – Finalet**





Në diten e fundit të garës ishte koha për finale. Kosova i kishte 2 gjimnaste të kualifikuara për finale në dy disiplina. Për fat të mirë gjimnastet nuk kishin ndonjë lëndim dhe ishin gati për garë. Nga ora 09:00 ishte finale në kapërcime.
Nga ekipi i Kosovës garoj e para Kaltrina Thaqi, e cila kishte këtë rezultat:
Tentimi 1: 11.350, tentimi 2: 11.850, bonus: 0.2.
Rezultat final: 11.800 – vendi i 7-të

Pastaj garoj Sara Pllana, e cila arriti këtë rezultat në Kapërcime**:**
Tentimi 1: 12.050, tentimi 2: 11.600
Rezultat final: 11.825 – medalje e bronztë, **vendi i 3-t**ë
Pastaj nga ora 12:15 filloj finalja në veglen parter. Në këtë disiplinë garoj Sara Pllana dhe arriti këtë rezultat: 11.900 – **medalje e artë**, vendi i pare.



Dita 6 **09 Qershor 2025 – Kthimi**

Check-out nga hoteli u bë në ora 10:00.
Nisja nga Maribori u bë në ora 14:00.
Me kërkesë të trajneres Doruntine, ekipi e priti Saren të përfundonte një seancë stërvitore me koreografe nga ora 08:00 deri në ora 13:30 dhe pjesa tjeter e ekipit kan pritur.
Mbërritja në Prishtinë u bë në orën 02:40 të datës 10 Qershor 2025.

Përfundim

Pjesëmarrja e Federatës së Gjimnastikës së Kosovës në garën ndërkombëtare "56th Šalamunov Memorial 2025" në Maribor të Sllovenisë rezultoi të jetë një ndër pjesëmarrjet më të suksesshme ndër vite për gjimnastikën tonë.
Gjatë kësaj gare u arritën 3 finale individuale, në kategori të ndryshme dhe u fituan 3 medalje individuale: një e artë dhe dy të bronzta.

Faleminderit për mbështetjen të gjithë atyre që kontribuan në realizimin e kësaj pjesëmarrjeje e sidomos faleminderit trajnerit Besnik Latifi që i huazoj parat për FGJK-në për pjesëmarrje në këtë garë.

Rezultatet e plota të garës mund të gjenden në linkun:
https://www.salamunov-memorial.si/sl-si/

Amir Tahiraga _____
Sekretar i Përgjithshëm i FGJK-së